



BASHKIA  
TIRANË  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME

## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Drejtuar: **Operatorit ekonomik NDREGJONI shpk**

Adresa: Rruga Sulë Bega , Ndërtesa Nr. 32 , Hyrja 8 , Njësia Bashkiake Nr. 8, Tiranë

Procedura e prokurimit : **Procedurë e Hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **Nr.Ref-32540-06-10-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “ **Mirëmbajtje e sistemit të ngrohjes dhe ventilimit, sistemit të detektimit të zjarrit, sistemi i ujit të pijshëm në Konviktet e Shkollave të Mesme, Bashkia Tiranë**”.

**Fondi limit: 39.583.333 (tridhjetë e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH**

**Burimi i financimit:** Fond i vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë deleguar pranë Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme me shkresën Nr.14865, datë 18.04.2022 “Njoftim për ndryshim buxheti sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.18, datë 06.04.2022.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.80, datë 20 Qershor 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori ekonomik “2Z Konstruksion” shpk** **NUIS- J63229466K**  
Vlera totale e ofertës pa TVSH = 39,002,432.58 (tridhjetë e nëntë milion e dy mijë e katërqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë e tetë) lekë.
- 2. Operatori ekonomik “ALTEC” shpk** **NUIS-K57923807W**  
Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
- 3. Operatori ekonomik “Eduart Çela” Person Fizik** **NUIS-M03806202I**  
Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
- 4. Operatori ekonomik “Liqeni VII” sha** **NUIS-K01730502W**

Vlera totale e ofertës pa TVSH = 39,388,446.61 (tridhjetë e nëntëmilion e treqind e tetëdhjetë e tetëmijë e katërqind e dyzet e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e një) lekë.

- 5. Operatori ekonomik “NDREGJONI” shpk** **NUIS-K31329048I**  
Vlera totale e ofertës pa TVSH = 38.405.484,86 (tridhjetë e tetëmilion e katërqind e pesëmijë e katërqind e tetëdhjetë e katër presje tetëdhjetë e gjashtë) lekë.
- 6. Operatori ekonomik “Sulollari - Klima” shpk** **NUIS-K01529003M**  
Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. Operatori ekonomik “2Z Konstruksion” shpk** **NUIS- J63229466K**

Për arsytet sa më poshtë:

- a) Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” pika 1, germa(b) përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:*

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 791.667 (shtatëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “2Z Konstruksion” komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se nga ky operator ekonomik nuk është paraqitur Formulari i sigurimit të ofertës sikundër kërkuar në dokumentat e tenderit duke mosplotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, pika 1, germa (b).*

- b) Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” pika 2.3.1, përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:*

**2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:**

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **19.791.667 (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë ne nje vlere jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **79.166.666 (shtatëdhjetë e nëntëmilion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

***Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar,
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur “Kontratë për kryerjen e punimeve të ndërtimit” me Nr.115 Rep, Nr.69 Kol të lidhur me shoqërinë “Erjoni -Agro” shpk.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se për këtë kontratë operatori ekonomik nuk ka paraqitur “Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9” dhe gjithashtu nuk ka paraqitur Akt kolaudimin e objektit duke mos plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.1, gërma (b).

**c) Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” pika 2.3.3 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:**

**2.3.3** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b) Diplomë

Drejtuesi teknik të paraqesë një deklaratë personale me shkrim që nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e cila duhet të bashkshoqëroje deklaratën e administratorit.

*(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkëpunimit.Ne të gjitha rastet drejtuesi teknik duhet të paraqesë deklaratën personale me shkrim që nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e cila duhet të bashkshoqëroje deklaratën e administratorit ).*

Nga verifikimi i dokumentacionit të shoqërisë “2Z Konstruksion” shpk konstatohet se nuk është paraqitur deklaratë për drejtuesin teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe gjithashtu nuk është paraqitur as deklaratë personale me shkrim e drejtuesit teknik që nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e cila duhet të bashkëshoqëroje deklaratën e administratorit sikundër kërkuar në kriterin sa më sipër.

Komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik nuk plotëson kriterin përcaktuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim kapaciteti teknik sikundër kërkuar nga autoriteti kontraktor.

***ç) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:***

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në licencën e shoqërisë për këtë objekt të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Shkurt 2022-Prill 2022 si më poshtë:

- Inxhinier ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier elektrik 1 (një)
- Inxhinier mekanik 1 (një)

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese së inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.3.4 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

***Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarinimin e mësipërm.***

Kriteri sipas pikës 2.3.4 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Sa më sipër operatori ekonomik “2Z Konstruksion” shpk referuar formularit përmbledhës të vetdeklarimit ka deklaruar ing. Kozeta Demi Inxhinier Ndërtimi, Ing.Pajtim Toci Inxhinier Topograf dhe Ing. Frederik Zere me profesion Inxhinier Elektrik. Referuar kriterit të përcaktuar komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka vetdeklaruar se disponon si pjese të stafit Inxhinier Hidroteknik dhe Inxhinier mekanik sikundër kërkuar në dokumentat e tenderit.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 dhe gërma “h” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

**2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon fuqinë puntore të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”;** Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “c” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta

të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj[....]”

Pra sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.4.

**d) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:**

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf teknik të pajisur me diploma/certifikata të arsimit profesional si dhe certifikata të sigurimit teknik të leshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për në listëpagesa për periudhën Shkurt 2022-Prill 2022 minimalisht si më poshtë:

- Punonjës Teknik elektroteknik 1 (një)
- Punonjës Murator 1 (një)
- Punonjës suvaxhi 4 (kater)
- Punonjës Hidroizolues 2 (dy)
- Punonjës Bojaxhi 5 (pese)
- Punonjës Sisteme ngrohje-ftohje 4 (katër)
- Punonjës Saldimi 2 (dy)
- Punonjës Mekanike 3 (tre)
- Punonjës Hidraulike 3 (tre)
- Punonjës Elektricitë 3 (tre)
- Punonjës Hekurkthyes 1 (një)
- Punonjës Karpentier 3 (tre)
- Punonjës Pllakashtrues 4 (katër)
- Punonjës Punime gips 2 (dy)
- Punonjës Punime duralumini/pvc 3 (tre)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- një dokument (diplomë,certifikate e arsimit profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm)
- Certifikate të sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione të autorizuara nga /ish (IQT) e cila të jete e leshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë
- **Diplomë** nga institucionet e arsimit të mesëm profesional(publik/privat) të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, kontratë pune të vlefshme dhe të figurojë në listëpagesa.
- Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:
-

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve punes	Nr.Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/Subjekti certifikues	Data vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	-------------------------------------	--	-----------------------------------	--

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “2 Z Konstruksion” komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se operatori ekonomik “2Z Konstruksion” nuk ka paraqitur deklaratën në lidhje me stafin që disponon sipas të dhënave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në tabelën sa më sipër duke mos plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim. Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.

Gjithashtu nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik “2Z Konstruksion” nuk ka vetdeklaruar se do të vërë në dispozicion të autoritetit kontraktor sa më poshtë:

- Punonjës Teknik elektroteknik
- Ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës suvaxhi Znj.Ronelda Zoga nga 4 (katër) punonjës të kërkuar në dokumentat e tenderit.
- Nuk ka deklaruar asnjë punonjës Hidroizolues ndërkohë që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklarojë 2 punonjës hidroizolues.
- Ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës bojaxhi Znj.Lavdie Çepele nga 5 (pesë) punonjës të kërkuar në dokumentat e tenderit.
- Nuk ka deklaruar asnjë punonjës Sisteme ngrohje-ftohje ndërkohe që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklarojë se disponon 4 punonjës sisteme ngrohje-ftohje.
- Ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës saldimi Z.Arsen Zoga nga 2 (dy) punonjës të kërkuar në dokumentat e tenderit.
- Nuk ka deklaruar asnjë punonjës Mekanik ndërkohë që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklarojë 3 (tre) punonjës mekanik.
- Nuk ka deklaruar asnjë punonjës Hidraulik ndërkohe që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklarojë se disponon 3 punonjës hidraulik.
- Ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës elektrikist Znj.Arsen Zoga nga 2 (dy) punonjës të kërkuar në dokumentat e tenderit.
- Ka deklaruar se disponon 2 (dy) punonjës karpentier Z.Daniel Çepele dhe Znj.Henrieta Kerri nga 3 (tre) punonjës të kërkuar në dokumentat e tenderit.
- Nuk ka deklaruar asnjë punonjës Pllakashtrues ndërkohe që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklarojë se disponon 4 punonjës pllakashtrues.
- Nuk ka deklaruar asnjë punonjës Punime Gipsi ndërkohe që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklarojë se disponon 2 punonjës Punime Gipsi.
- Nuk ka deklaruar asnjë punonjës Punime Duralumini ndërkohe që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklarojë se disponon 3 punonjës Punime Duralumini.

Eshtë barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë me informacion të saktë të vetdeklaruar ne Formularin përmbledhës të vetdeklarimit se disponon kapacitetet teknike në lidhje stafin teknik në dispozicion të autoritetit kontraktor.

Në përfundim të analizës së fakteve komisioni i vlersimit të ofertave arrin në konkluzionin se nga të dhënat e plotësuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit mbi stafin qe operatori ekonomik do të vërë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor konstatohet se operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e kriterëve të veçanta të kualifikimit për disponimin e stafit sikundër përcaktuar në dokumentet e tenderit të vendosura nga autoritetit kontraktor duke mosplotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.5.

**dh) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.6 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:**

**2.3.6** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në stafin teknik mbështetës të punësuar të vërtetuar me kontrate pune te vlefshme, si dhe të figurojnë në list pagesat e shoqërisë për per në listëpagesa për periudhën Shkurt 2022-Prill 2022

**a)** 3 (tre) Inxhinierë Ndërtimi të cilët të kenë kontratë pune, diplomë,Cv.

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “2 Z Konstruksion”shpk konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur vetëm 1 (një) inxhinier ndërtimi nga 3 (tre) të kërkuar duke mosplotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.6, germa (a).

**2.3.6** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në stafin teknik mbështetës të punësuar të vërtetuar me kontrate pune te vlefshme, si dhe të figurojnë në list pagesat e shoqërisë për per në listëpagesa për periudhën Shkurt 2022-Prill 2022

**b)** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si: 1(një) Punonjes- Auditues Energjie (i pajisur me certificate per auditimin e energjise)

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “2 Z Konstruksion”shpk konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur punonjës auditues-energjie (të pajisur me çertifikatë për auditimin e energjisë duke mosplotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.6, germa (b).

**e) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.7 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:**

**2.3.7** Numri mesatar i punonjësve duhet të jetë jo më pak se **58 (pesëdhjetë e tetë) punonjës** për periudhën **Shkurt 2022– Prill 2022**.Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

**a)** Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Shkurt 2022– Prill 2022**.

**b)** Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shkurt 2022– Prill 2022**.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik “2Z Konstruksion” shpk ka vetdeklaruar numrin e punonjësve për periudhen Shkurt 2022– Prill 2022 duke deklaruar se disponon 25 punonjës

Në përfundim të analizës së fakteve komisioni i vlersimit të ofertave arrin në konkluzionin se nga të dhënat e plotësuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit mbi numrin e punonjësve operatori ekonomik “2Z Konstruksion”shpk nuk plotëson numrin prej 58 punonjës të kërkuar duke mos plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3.7 mbi numrin mesatar të punonjësve sikundër përcaktuar në dokumentet e tenderit të vendosura nga autoritetit kontraktor.

**f) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.11 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:**

**2.3.11** Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 45001 (e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO nderkohe qe secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave të punimeve që

do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "2Z Konstruksion" shpk konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur ne sistemin e prokueimit elektronik Certifikatë ISO 45001 duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 2.3.11.

**g) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" Pika 2.3 "Kapaciteti teknik" pika 2.3.12 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:**

**2.3.12** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori.

Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet ( elektrike, hidraulike, sistemi ujit te pijshem, pllaka, dyer/dritare, gipse, bojrat, depozite nafte, pompat, kaldaja, sistemi i dedektimit te zjarrit) Per materialet e kerkuara te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmiteti CE ,certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.Per depoziten e lendes duhet të paraqesë; Çertifikatën e Konformitetit CE, Dokumentin e testimi te lyerjes se jashtme;Dokumenti i testimi hidrostatik;Certifikate kalibrimi;Certifikaten e inspektimit te materialit te perdorur.

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu,si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "2Z Konstruksion" shpk konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori për materialet ( elektrike, hidraulike, sistemi ujit te pijshem, pllaka, dyer/dritare, gipse, bojrat, depozite nafte, pompat, kaldaja, sistemi i dedektimit te zjarrit,) duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 2.3.12.

**h) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3.13 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Vinç me kosh 1 copë.**

Referuar deklarimit të bërë nga operatori ekonomik "2Z Konstruksion" shpk mbi disponimin e mjeteve konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar në shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" mjetin vinç me kosh duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13/4

**i) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3.13 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Matrapik 6 copë.**

Referuar deklarimit të bërë nga operatori ekonomik "2Z Konstruksion" shpk mbi disponimin e mjeteve konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar në shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" asnje pajisje matrapik duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13/8.

**j) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3.13 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Vinç karel (portativ) i levizshem me kapacitet deri 0.5 ton 3 copë.**



Referuar deklaramit të bërë nga operatori ekonomik "2Z Konstruksion" shpk mbi disponimin e mjeteve konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar në shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" asnjë mjet të tipit vinç karel (portativ) i lëvizshëm me kapacitet deri në 0.5 ton duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13/7

***k) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3.13 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës sa më poshtë:***

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"(i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës", dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi 50 (pesëdhjetë) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 (dhjetë) copë
- Karroca dore minimumi 10 (dhjetë) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 (njëzet) copë
- Fikse zjarri 10 (dhjetë) copë
- Jelekë minimum 50 (pesëdhjetë) copë

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon pajisjet sa më sipër duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13

***l) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3.14 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:***

**2.3.14** Grafiku i punimeve sipas të gjithave zërave të punimeve. (3 Muaj)

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "2Z Konstruksion" shpk konstatohet se ky operator ekonomik nuk ka paraqitur grafikun e punimeve për objektin duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: "4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kritereve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “2Z Konstruksion” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

## **2. Operatori ekonomik “ALTEC” shpk**

**NUIS-K57923807W**

Për arsytet sa më poshtë:

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se operatori ekonomik “ALTEC” shpk nuk ka paraqitur ofertën ekonomike ai ka paraqitur në sistem vetëm preventivin pa çmime dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër provues në plotësim të kritereve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kritereve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “ALTEC” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

## **3. Operatori ekonomik “Eduart Çela” Person Fizik**

**NUIS-M03806202I**

Për arsytet sa më poshtë:

1. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se operatori ekonomik “Eduart Çela”, Person Fizik nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. Ky operator ekonomik ka paraqitur në sistem vetëm Ekstraktin e Rregjistrimit Tregëtar dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër provues në plotësim të kritereve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit.
2. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.
3. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kritereve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “Eduart Çela”, Person Fizik nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

## **4. Operatori ekonomik “Liqeni VII” sha**

**NUIS –K01730502W**

Për arsytet sa më poshtë:

- a) *Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 1, germa(b) përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:*

## 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është **791.667 (shtatëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë**, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Liqeni VII” sha komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se ky operator ekonomik nuk ka paraqitur në sistmin e prokurimit elektronik Formularin e sigurimit të ofertës sikundër kërkuar në dokumentat e tenderit duke mosplotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, pika 1, germa (b).

**b) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:**

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar si staf teknik te pajisur me diploma/certifikata te arsimit profesional si dhe certifikata te sigurimit teknik te leshuara nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për në listëpagesa për periudhën Shkurt 2022-Prill 2022 minimalisht si më poshtë:

- |                                   |           |
|-----------------------------------|-----------|
| • Punonjës Teknik elektroteknik   | 1 (një)   |
| • Punonjës Murator                | 1 (një)   |
| • Punonjës suvaxhi                | 4 (kater) |
| • Punonjës Hidroizolues           | 2 (dy)    |
| • Punonjës Bojaxhi                | 5 (pese)  |
| • Punonjës Sisteme ngrohje-ftohje | 4 (katër) |
| • Punonjës Saldimi                | 2 (dy)    |
| • Punonjës Mekanike               | 3 (tre)   |
| • Punonjës Hidraulike             | 3 (tre)   |
| • Punonjës Elektracistë           | 3 (tre)   |
| • Punonjës Hekurkthyes            | 1 (një)   |
| • Punonjës Karpentier             | 3 (tre)   |
| • Punonjës Pllakashtrues          | 4 (katër) |
| • Punonjës Punime gips            | 2 (dy)    |
| • Punonjës Punime duralumini/pvc  | 3 (tre)   |

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- një dokument (diplomë, certifikate e arsimit profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm)
- Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise
- **Diplomë** nga institucionet e arsimit të mesëm profesional (publik/privat) të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, kontratë pune të vlefshme dhe të figurojë në listëpagesa.
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve punes	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/Subjekti certifikues	Data vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	-------------------------------------	---	-----------------------------------	--

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Liqeni VII” sha komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se operatori ekonomik “Liqeni VII” sha nuk ka paraqitur deklaratën në lidhje me stafin që disponon sipas të dhënave dhe formatit të kërkuar nga autoriteti kontraktor duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim. Kapaciteti Teknik, pika 2.3.5.

Gjithashtu nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik “Liqeni VII” sha ka vetdeklaruar me mangësi stafin teknik që do të vihet në dispozicion të autoritetit kontraktor sa më poshtë:

- Ka deklaruar se disponon vetëm 2 (dy) punonjës suvaxhi Z.Sadik Nezha dhe Z. Nikoll Ndoj nga 4 (katër) punonjës suvaxhi të kërkuar në dokumentat e tenderit.
- Ka deklaruar se disponon vetëm 4 (katër) punonjës bojaxhi Z. Misim Kalia, Z. Klement Harizi, Z.Lutfi Nezha dhe Znj. Kujtime Loka nga 5 (pesë) punonjës bojaxhi të kërkuar në dokumentat e tenderit.
- Ka deklaruar se disponon vetëm 1 (një) punonjës Sisteme ngrohje-ftohje Z. Ramazan Kalia ndërkohe që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklarojë se disponon 4 (katër) punonjës sisteme ngrohje-ftohje.
- Ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës saldimi Z.Maltin Ndoj nga 2 (dy) punonjës të kërkuar në dokumentat e tenderit.
- Ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës Mekanik Z.Lavdrim Domi ndërkohë që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të disponojë dhe vetdeklaroje 3 (tre) punonjës mekanik.
- Ka deklaruar se disponon 2 (dy) punonjës Hidraulik Z. Imer Bushi dhe Z. Fadil Tërshalla ndërkohë që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklaroje se disponon 3 (tre) punonjës hidraulik.
- Ka deklaruar se disponon 2 (dy) punonjës elektrikist Z.Artenis Kalia dhe Z.Ardian Keqa nga 3 (tre) punonjës të kërkuar në dokumentat e tenderit.
- Ka deklaruar se disponon vetëm 1 (një) punonjës karpentier Z.Alket Voka nga 3 (tre) punonjës të kërkuar në dokumentat e tenderit.
- Ka deklaruar se disponon vetëm 1 (një) punonjës Pllakashtrues Z.Vilson Simoni ndërkohë që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklaroje se disponon 4 (katër) punonjës pllakashtrues.
- Ka deklaruar se disponon vetëm 1 (një) punonjës për Punime Gipsi Z.Fadil Koci ndërkohë që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklaroje se disponon 2 punonjës Punime Gipsi.
- Ka deklaruar se disponon vetëm 1 (një) punonjës Punime Duralumini Z.Klejvi Zyka ndërkohë që referuar pikës 2.3.14 është kërkuar të vetdeklaroje se disponon 3 punonjës Punime Duralumini.

Eshtë barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë me informacion të saktë të vetdeklaruar në Formularin përmbledhës të vetdeklarimit se disponon kapacitetet teknike në lidhje me stafin teknik që do të vërë në dispozicion të autoritetit kontraktor për realizimin e kontratës.

Në përfundim të analizës së fakteve komisioni i vlerësimit të ofertave arrin në konkluzionin se nga të dhënat e plotësuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit mbi stafin që operatori ekonomik do të vërë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor konstatohet se operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e kriterëve të vecanta të kualifikimit për disponimin e stafit sikundër përcaktuar në dokumentet e tenderit të vendosura nga autoritetit kontraktor duke mosplotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.5.

*c) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.6 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:*

**2.3.6** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në stafin teknik mbështetës të punësuar të vërtetuar me kontrate pune të vlefshme, si dhe të figurojnë në list pagesat e shoqërisë për per në listëpagesa për periudhën Shkurt 2022-Prill 2022

**a)** 3 (tre) Inxhinier Ndërtimi të cilët të kenë kontratë pune, diplomë, Cv.

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Liqeni VII”sha konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur vetëm 2 (dy) inxhinier ndërtimi nga 3 (tre) të kërkuar duke mosplotësuar kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.6, germa (a).

*c) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.7 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:*

**2.3.7** Numri mesatar i punonjësve duhet të jetë jo më pak se **58 (pesëdhjetë e tetë) punonjës** për periudhën **Shkurt 2022– Prill 2022**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

**c)** Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Shkurt 2022– Prill 2022**.

**d)** Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shkurt 2022– Prill 2022**.

*Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik “Liqeni VII” sha ka vetdeklaruar numrin e punonjësve për periudhën Shkurt 2022– Prill 2022 duke deklaruar se disponon 57 punonjës

Në përfundim të analizës së fakteve komisioni i vlersimit të ofertave arrin në konkluzionin se nga të dhënat e plotësuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit mbi numrin e punonjësve operatori ekonomik “Liqeni VII” sha nuk plotëson numrin prej 58 punonjës të kërkuar duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7 mbi numrin mesatar të punonjësve sikundër përcaktuar në dokumentet e tenderit të vendosura nga autoritetit kontraktor.

*d) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.12 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:*

**2.3.12** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet ( elektrike, hidraulike, sistemi ujit të pijshëm, pllaka, dyer/dritare, gipse, bojrat, depozite naftë, pompat, kaldaja, sistemi i dedektimit të zjarrit,)Per materialet e kerkuara te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ,certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.Per depoziten e lendes duhet të paraqesë; Çertifikatën e Konformitetit CE, Dokumentin e testimit të lysterjes se jashtme;Dokumenti i testimit hidrostatik;Certifikate kalibrimi;Certifikaten e inspektimit të materialit të përdorur.

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Liqeni VII" sha konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori për materialet (elektrike, hidraulike, sistemi ujit te pijshem, pllaka, dyer/dritare, gipse, bojrat, depozite nafte, pompat, kaldaja, sistemi i dedektimit te zjarrit,) duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 2.3.12.

***dh) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3.13 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Kamioncine kapaciteti mbajtes 3-3.5 ton 3 copë.***

Referuar deklaramit të bërë nga operatori ekonomik "Liqeni VII" sha konstatohet se ne plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik në shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" ka deklaruar vetëm mjetin me targa AA 574 JU duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13/2 ku kërkohen specififikisht 3 (tre) mjete kamioncine me kapacitet 3-3.5 ton.

***e) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3.13 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Vinç karel (portativ) i lëvizshem me kapacitet deri 0.5 ton 3 copë.***

Referuar deklaramit të bërë nga operatori ekonomik "Liqeni VII" sha mbi disponimin e mjeteve konstatohet se operatori ekonomik ka deklaruar në shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" vetem 1 mjet të tipit vinç karel (portativ) i lëvizshem me kapacitet deri në 0.5 ton duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13/7 ku kërkohen specififikisht 3 (tre) mjete vinç karel (portativ) të lëvizshëm me kapacitet deri ne 0.5 ton.

***f) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3.13 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Balonë Ndriçimi***

Referuar deklaramit të bërë nga operatori ekonomik "Liqeni VII" sha konstatohet se në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik në shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" nuk ka deklaruar pajisjen Balonë Ndriçimi duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13/10

***g) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3.13 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës sa më poshtë:***

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"(i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës", dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi 50 (pesëdhjetë) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 (dhjetë) copë
- Karroca dore minimumi 10 (dhjetë) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 (njëzet) copë

- Fikse zjarri 10 (dhjetë) copë
- Jelekë minimum 50 (pesëdhjetë) copë

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik Nuk ka deklaruar se disponon pajisje prozhektorë ndriçimi natën.

Nuk ka deklaruar se disponon karroca dore.

Nuk ka deklaruar se disponon jelekë pune

Ka deklaruar se disponon Fikse Zjarri 5 (pesë) copë nga 10 (dhjetë) copë të kërkuara.

Sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13 në lidhje me mjetet dhe paisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve,

**h) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” pika 2.3.14 percaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar per kete procedure prokurimi duhet te plotësojnë kriterin sa më poshtë:**

**2.3.14** Grafiku i punimeve sipas të gjithave zërave të punimeve. (3 Muaj)

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ”Liqeni VII”sha konstatohet se ky operator ekonomik nuk ka paraqitur grafikun e punimeve për objektin duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kritereve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “Liqeni VII” sh.a nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

**5. Operatori ekonomik “Sulollari-Klima” shpk**

**NUIS-K01529003M**

*Për arsyet sa më poshtë:*

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se operatori ekonomik “Sulollari-Klima”shpk nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik vetëm Ekstraktin e rregjistrir tregtar dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër provues në plotësim të kritereve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat

dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kritereve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “Sulollari-Klima” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**NDREGJONI**” shpk me adresë: Rruga Sulë Bega , Ndërtesa Nr. 32 , Hyrja 8 , Njësia Bashkiake Nr. 8, Tiranë se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 38.405.484,86 (tridhjetë e tetëmilion e katërqind e pesëmijë e katërqind e tetëdhjetë e katër presje tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.